



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**RREGULLORE**

**RREGULLORE MBI MËNYRAT, KUSHTET DHE PROCEDURAT E PAGESAVE  
TË PENSIONIT VULLNETAR**

*Miratuar me Vendim Bordi nr. 126, datë 7.12.2010*

**Neni 1  
Objekti**

Kjo rregullore përcakton mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit në llogarinë e anëtarit të fondit të pensioneve vullnetare, pasi ka fituar të drejtën e tërheqjes dhe përdorimit të tyre në bazë të dispozitave ligjore.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të dispozitave të nenit 16, paragrafi 2, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensioneve Vullnetare”, këtu e më poshtë (“Ligji”). Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim dhënë atyre në Ligj.

**Neni 3  
Kushtet dhe mënyrat e pagesave të pensionit**

1. Anëtari i fondit të pensionit ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet ose pagesa periodike në formë pensioni pasi të ketë arritur moshën e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
2. Me lindjen e së drejtës së marrjes së pagesës së pensionit, anëtari i fondit të pensionit, mund t’i tërheqë dhe/ose përdorë asetet neto në llogarinë e tij të pensionit sipas mënyrave të mëposhtme:
  - a. marrjen e pagesës së menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet të pensionit, ose një pjesë të saj;
  - b. marrjen e vlerës neto të aseteve të llogarisë së vet, apo një pjese të saj nëpërmjet pagesave periodike që i përgjigjen asaj;
  - c. përdorimin e vlerës neto të aseteve të llogarisë së vet, apo të një pjese të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “të përvitshme” të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës;

- d. kombinimin e mënyrave të cituara në pikat a, b, dhe c më sipër.

#### **Neni 4**

##### **E drejta e për informim**

1. E drejta e pakushtëzuar e anëtarit të fondit për marrjen e pagesës së menjëhershme të të gjitha aseteve neto në llogarinë e tij në fondin e pensionit, apo e pagesave periodike në formë pensioni, pas plotësimit të kushteve sipas legjislacionit në fuqi, duhet të jetë e shkruar qartë në kontratën dhe prospektin e fondit të pensionit vullnetar.
2. Shoqëria administruese e fondit të pensionit detyrohet të njoftojë anëtarin 3-muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tij të pensionit.

#### **Neni 5**

##### **Pagesat periodike te pensionit**

1. Me lindjen e së drejtës së marrjes së pagesës së pensionit, anëtari i fondit të pensionit mund të zgjedhë të marrë asetet neto në llogarinë e tij të pensionit në formën e pagesave periodike të planifikuara sipas skedulit të përcaktuar në një kontratë të veçantë, që nënshkruhet midis anëtarit të fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese.
2. Pagesat periodike do të kryhen nga shoqëria administruese në një llogari bankare të anëtarit të fondit të pensionit brenda afateve të përcaktuara në skedulin e pagesave të përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni.

#### **Neni 6**

##### **Pagesat e vonuara**

1. Në rastin e vonesave në pagimin e shumave të menjëhershme apo të pagesave periodike, Shoqëria administruese detyrohet t'i paguajë anëtarit të fondit të pensionit shumën shtesë, në formë interesi. Në llogaritjen e interesit do të përdoret norma e interesit TRIBID, 12 mujore e kërkuar për pranimin e depozitave, e publikuar nga Banka e Shqipërisë, plus 5%.
2. Shuma e interesit të pagueshëm tek anëtari i fondit për çdo pagesë të vonuar llogaritet proporcionalisht:
  - (a) për çdo ditë vonese, duke filluar që nga dita e parë kur lind detyrimi për kryerjen e pagesës, deri në ditën kur kryhet pagesa;
  - (b) mbi shumën e pagesës së vonuar.

#### **Neni 7**

##### **Blerja e sigurimit të jetës në formë “të përvitshme”**

1. Shoqëria administruese mund t'i propozojë anëtarit t'i investojë asetet në blerjen e një police të sigurimit në formën e një “të përvitshmeje”.
2. Me lindjen e së drejtës së pensionit, anëtari mund të zgjedhë blerjen e një police të sigurimit të “të përvitshme”.

3. Shoqëria administruese i propozon shoqërinë e sigurimit të jetës ku mund të blejë policën, por është e drejta e anëtarit të fondit të pensionit të zgjedhë shoqërinë e sigurimit të jetës ku ai do të transferojë fondet e akumuluar.
4. Sigurimi i “të përvitshmes” sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të jetë:
  - a. “e përvitshme” e përvitshme, që nënkupton pagesa përfitimi periodik deri në vdekjen e të siguruarit;
  - b. “e përvitshme” me afat të përcaktuar, që nënkupton pagesa përfitimi që kryhen brenda një periudhe të caktuar kohe;
  - c. “e përvitshme” e përbashkët, që nënkupton pagesa periodike, të cilat me vdekjen e njërit nga të siguruarit, vazhdojnë t’i kryhen të siguruarit tjetër dhe me vdekjen e këtij të fundit, trashëgimtarit ligjor.
5. Modalitetet e pagesave periodike, koha e fillimit, përfundimit të pagesave dhe çështje të tjera të ngjashme do të përcaktohen në kontratën e sigurimit.
6. Dispozitat e nenit 6, zbatohen për shoqërinë e sigurimit të jetës, në rast se pagesat e “të përvitshmes” nuk kryhen sipas skedulit të miratuar me kontratën e sigurimit të jetës.

## **Neni 8**

### **Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Elisabeta GJONI**